

Moszbatimi i vendimeve gjyqësore

*PALIGJSHMËRIA E QEVERISË KURTI DHE
ABUZIMI ME USHTRUES DETYRE*



09/25



Autor: Gzim Shala dhe Naim Jakaj

Me kontribut të Florian Smajli dhe Melos Kolshi

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e National Endowment for Democracy dhe Rockefeller Brothers Fund.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

Përkrahur nga:

IKD

Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org



Shtator 2025
Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive	4
PJESA I	4
Qeveria e kundërligjshme	5
2. Hyrje	5
3. Papajtueshmëria kushtetuese dhe ligjore	6
4. Vendimi i Gjykatës Supreme	8
5. Pasojat e mos zbatimi të vendimit të Gjykatës Supreme	10
6. Përgjegjësia penale.....	12
Pjesa II	14
Qeverisja me ushtrues detyre	14
7. Qeverisja me ushtrues detyre	14
8. Korniza ligjore	15
9. Vendimi i Gjykatës Supreme	16
10. Pasojat e qeverisjes me ushtrues detyre	17

1. Përmbledhje ekzekutive

Kushtetuta e Republikës së Kosovës prerazi e ndalon që i njëjti person të mbajë njëkohësisht edhe pozitën e deputetit edhe atë të anëtarit të qeverisë. Këtë ndalesë e përmban edhe Ligji për Qeverinë, i sponsorizuar nga Qeveria tani në detyrë dhe miratuar në kohën kur kjo Qeveri kishte shumicën parlamentare në Kuvend. Përkundër kësaj, shumica e anëtarëve të Qeverisë në detyrë mbajnë edhe pozitën e deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kjo duke bërë që i njëjti person të jetë si anëtarë i institucionit mbikëqyrës, Kuvendit, ashtu edhe i institucionit mbikëqyrës, qeverisë.

Pamundësia e mbajtjes së dy (2) pozitave, asaj të anëtarit të Qeverisë në detyrë dhe deputetit në Kuvendin e Kosovës, është konfirmuar edhe nga Gjykata Supreme. Qeveria në detyrë nuk e përmbushi standardin e vendosur nga Gjykata Supreme, por iu vërsul gjyqtarëve të saj.

Mos lëshimi i zyrave të Qeverisë në detyrë nga personat që janë edhe deputetë të Kuvendit ka pasoja shumëdimensionale. Pos cenimit të sundimit të ligjit në Kosovë, kjo situatë ka dëmtuar edhe imazhin e Kosovës tek partnerët ndërkombëtarë, të cilat kanë theksuar se nuk do të zhvillojnë takime me Kryeministrin në detyrë dhe ministrat brenda ndërtesës së Qeverisë së Kosovës, derisa të jetë në funksion një qeveri me mandat të plotë. Në anën tjetër, në kuptim të vendimit të Gjykatës Supreme, të gjitha vendimet të cilat merren nga anëtarët e qeverisë të cilët janë edhe deputet, janë të kundërligjshme. Në pamundësi për tu atakuar secili vendim, kjo situatë e mbush rendin juridik me vendime të kundërligjshme. Kjo situatë tërheq pas vetes edhe përgjegjësi penale, e cila përgjegjësi aktualisht është duke u shqyrtuar nga PSRK. Për më tepër, kjo situatë rrezikon të ketë implikime edhe në përzgjedhjen e Kryetarit të ri të Kuvendit.

Në anën tjetër, Qeveria Kurti II është cilësuar si një qeverisje me ushtrues detyre. Gjatë kësaj qeverisje, një numër jashtëzakonisht i madh i pozitave janë mbajtur për vite të tëra me ushtrues detyre, ashtu që nuk janë emëruar titullarët e ri përmes proceseve të rregullta dhe meritore të rekrutimit. Edhe në raport me ushtruesit e detyrës, Gjykata Supreme theksoi se asnjë pozitë nuk mund të mbahet me ushtrues detyre pas kalimit të afatit të përcaktuar me ligj, edhe nëse ndryshohet emri i zyrtarit që ushtron pozitën. Nëse kjo ndodhë, sipas Gjykatës Supreme, të gjitha vendimet e nxjerra konsiderohen të kundërligjshme.

Standardet ndërkombëtare theksojnë rëndësinë që mbajtja e pozitave me ushtrues detyre duhet të trajtohet vetëm si përjashtim. Në secilin rast, standardet e qeverisjes së mirë në administratën publike kërkojnë rekrutim të bazuar në meritë dhe jo mbajtje të pozitave me ushtrues detyre. Megjithatë, e kundërta ndodhi me Qeverinë Kurti II, e cila mbajtjen e pozitave me ushtrues detyre e konsideroi si rregull dhe jo si përjashtim.

Mbajtja e pozitave me ushtrues detyre ka po ashtu pasoja shumë dimensionale. Përmes kësaj mënyre të veprimit cenohet meritokracia e proceseve rekrutuese dhe cenohet administrimi adekuat i institucioneve publike. Për më tepër, për shkak të mungesës së procedurës për caktimin e ushtruesve të detyrës dhe mungesës së garancive për largimin e tyre, mbajtja e pozitave me ushtrues detyre paraqet një burim të lartë potencial të korrupsionit.

PJESA I

Qeveria e kundërligjshme

2. Hyrje

Qeveria Kurti II e Republikës së Kosovës është zgjedhur më 22 mars 2021. Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ajo ka pasur mandat deri më 22 mars 2025. Nga kjo datë, Qeveria Kurti II ka kaluar në Qeveri në detyrë.

Në anën tjetër, më 9 shkurt 2025 janë mbajtur zgjedhjet parlamentare në Republikën e Kosovës¹. Rezultatet e këtyre zgjedhjeve janë certifikuar më 27 mars 2025², derisa Presidentja e Republikës së Kosovës ka thirrur seancën konstituive për datën 15 prill 2025³. Kurse, Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës u betuan më 19 prill 2025⁴. Aktualisht, këtu bëjnë pjesë Kryeministri së bashku me 13 ministra dhe 1 zëvendësministre. Po ashtu, në mesin e tyre bënin pjesë edhe ish-ministrja e Ministrisë së Drejtësisë, Albulena Haxhiu dhe ish-zëvendëskryeministrja e tretë, Emilja Redžepi. Mirëpo, të njëjtat dhanë dorëheqje nga këto pozita vetëm pas zgjedhjes së tyre si nënkryetare të Kuvendit. Pas betimit të deputetëve, konstituimi i Kuvendit u përfshi në një krizë politike, ashtu që deri në ditën e publikimit të këtij raporti, Kuvendi nuk është konstituuar ende, ndonëse Kryetari i Kuvendit e ka konstatuar këtë.

Kështu, megjithëse të njëjtit u certifikuan dhe u betuan si deputetë, ata nuk dhanë dorëheqje nga pozita e anëtarit të qeverisë. Në kundërshtim me Kushtetutën dhe Ligjin, ata vazhduan të mbajnë të dy pozitat. Kundërligjshmëria në mbajtjen e këtyre dy (2) pozitave u konfirmua edhe nga Gjykata Supreme⁵. Megjithatë, në vend të përmbushjes së minimumit legjitim të pritur, pra implementimit të vendimit të Gjykatës Supreme, anëtarët e Qeverisë iu vërsulën Gjykatës Supreme derisa nuk zbatuan vendimin e saj.

Përderisa, çështja e mbajtjes së dy pozitave në të njëjtën kohë është duke u trajtuar edhe nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës⁶.

¹ "Në Kosovë po zhvillohen zgjedhjet parlamentare". Deutsche Welle. 9 shkurt 2025. (Shih linkun: <https://www.dw.com/sq/në-kosovë-po-zhvillohen-zgjedhjet-parlamentare/a-71552060>)

² "KQZ certifikoi rezultatet përfundimtare të Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës, 9 shkurt 2025". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. 27 mars 2023. (Shih linkun: <https://kqz-ks.org/kqz-certifikoi-rezultatet-perfundimtare-te-zgjedhjeve-per-kuvendin-e-kosoves-9-shkurt-2025/>)

³ "Presidentja Osmani thërret seancën konstituive të Legjislaturës së nëntë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për datën 15 prill". 1 prill 2025. (Shih linkun: <https://president-ksgov.net/presidentja-osmani-therret-seancen-konstituive-te-legjislatures-se-nente-te-kuvendit-te-republikes-se-kosoves-per-daten-15-prill/>).

⁴ "Deputetët e rinj betohen pas verifikimit të mandateve". Betimi për Drejtësi. 19 prill 2025. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/deputetet-e-rinj-betohen-pas-verifikimit-te-mandateve/>).

⁵ Aktgjykimi i Gjykatës Supreme së Republikës së Kosovës (P.A.nr.09/2025), marrë më 15 qershor 2025. (Shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/SUP_09-2025_SQ.pdf).

⁶ "LDK-ja dorëzon 17 kallëzime penale ndaj Kurtit dhe ministrave që u bënë deputetë". Betimi për Drejtësi. 8 maj 2025. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ldk-ja-dorezon-17-kallezime-penale-ndaj-kurtit-dhe-ministrave-qe-u-bene-deputete/>).

Nr.	Emri	Pozita
1	Albin Kurti	<i>Kryeministër</i>
2	Donika Gërvalla – Schëarz	<i>Zëvendëskryeministre e dytë dhe ministre e Punëve të Jashtme dhe Diasporës</i>
3	Hekuran Murati	<i>Ministër i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve</i>
4	Ejup Maqedonci	<i>Ministër i Ministrisë së Mbrojtjes</i>
5	Xhelal Sveçla	<i>Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme</i>
6	Arben Vitia	<i>Ministër i Ministrisë së Shëndetësisë</i>
7	Arbërie Nagavci	<i>Ministre e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit</i>
8	Hajrulla Çeku	<i>Ministër i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit</i>
9	Elbert Krasniqi	<i>Ministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal</i>
10	Faton Peci	<i>Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural</i>
11	Artane Rizvanolli	<i>Ministre e Ministrisë së Ekonomisë</i>
12	Rozeta Hajdari	<i>Ministre e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë</i>
13	Nenad Rašić	<i>Ministër i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim</i>
14	Fikrim Damka	<i>Ministër i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal</i>
15	Liza Gashi	<i>Zëvendësministre e Punëve të Jashtme dhe Diasporës</i>
16	Emilja Redžepi	<i>Zëvendëskryeministre (Deri më 26 gusht 2025)</i>
17	Albulena Haxhiu	<i>Ministre e Drejtësisë (Deri më 26 gusht 2025)</i>

Tabela 1: Emrat e minsitrave dhe zëvendësministres aktuale, që njëkohësisht janë edhe deputetë.

3. Papajtueshmëria kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës prerazi e ndalon që i njëjti person të mbajë njëkohësisht edhe pozitën e deputetit edhe atë të anëtarit të qeverisë. Për këtë, Kushtetuta ka theksuar se “Mandati i deputetit mbaron ose bëhet i pavlefshëm, nëse: emërohet anëtar i Qeverisë së Kosovës” si dhe “Deputeti i Kuvendit të Kosovës nuk mund të mbajë ndonjë post ekzekutiv në

administratën publike ose në ndonjë ndërmarrje në pronësi publike, dhe as të ushtrojë ndonjë funksion tjetër ekzekutiv, sikurse është përcaktuar me ligj".⁷

Për vite me radhë, Kosova nuk kishte pasur Ligj për Qeverinë. Projektligji për Qeverinë ishte miratuar me 29 dhjetor 2021 në mbledhjen e 52 të Qeverisë Kurti II⁸. Përderisa, i njëjti projektligj ishte miratuar në Kuvendin e Kosovës me 27 tetor 2022 dhe kishte hyrë në fuqi në dhjetor të vitit 2022.⁹

Ligji Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës përcakton se "*Në rast se anëtari i Qeverisë në detyrë zgjidhet deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i njëjti duhet të jap dorëheqje nga posti i anëtarit të Qeverisë para ditës së certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve*". Po ashtu, ky ligj përcakton specifikisht se "*Mandati i anëtarit të Qeverisë përfundon, nëse:.... Zgjidhet deputet i Kuvendit*".¹⁰

Kështu, sikurse dispozitat kushtetuese ashtu edhe dispozitat ligjore qartësojnë pamundësinë e ushtrimit të dy (2) pozitave, atë të anëtarit të Qeverisë dhe deputetit të Kuvendit, në të njëjtën kohë.

Argumenti i Qeverisë i dhënë në publik ishte se Qeveria në detyrë duhet të vazhdojë të funksionojë deri në momentin e zgjedhjes së Qeverisë së re. Sipas tyre "*...Qeveria në detyrë apo në dorëheqje mbetet e tillë deri në momentin e zgjedhjes së një Qeverie të re*".¹¹

Ky argument i dhënë nga Qeveria nuk ka mbështetje në kushtetutë dhe në ligj. Dispozitat ligjore tregojnë se përmes këtij argumenti, Qeveria ngatërron konceptin e qeverisë në detyrë si institucion me konceptin e anëtarit të qeverisë si individ.

Siç u theksua, Ligji Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, kur flet për papajtueshmërinë, i referohet "*anëtarit të qeverisë*", e jo qeverisë si institucion. Neni 4 i këtij Ligji flet për përbërjen e qeverisë, duke theksuar se "*Qeveria përbëhet nga Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat*". Pra, kur flitet për papajtueshmërinë, në këtë rast për ushtrimin të dy (2) pozitave në të njëjtën kohë, Kushtetuta dhe Ligji nuk i referohen qeverisë si institucion, por secilit anëtar të saj si individ. Për këtë arsye, neni 26.1. i Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë kërkon dorëheqjen e anëtarit të qeverisë në detyrë dhe jo largimin e qeverisë në detyrë.

Në anën tjetër, kur flitet për Qeverinë në dorëheqje, Ligji Nr.08/L-117 për Qeverinë i referohet institucionit dhe jo anëtarit të qeverisë. Kjo argumentohet edhe me faktin se sipas këtij Ligji, Qeveria konsiderohet në dorëheqje edhe në rastet kur vet Kryeministri jep dorëheqje . Pra,

⁷ Neni 70.3. (3) dhe Neni 72. Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Qershor, 2008..

⁸ "Mbledhja e fundit e Qeverisë për këtë vit, të gjitha vendimet që u morën". Ekonomia Online. 29 dhjetor 2021. (Shih linkun: <https://ekonomiaonline.com/mbledhja-e-fundit-e-qeverise-per-kete-vit-te-gjitha-vendimet-qe-u-moren/>).

⁹ "Kuvendi miraton në parim Projektligjin për mbështetjen e punëve publike". Indeksonline. 27 tetor 2022. (Shih linkun: <https://indeksonline.net/kuvendi-miraton-ne-parim-projektligjin-per-mbeshtetjen-e-puneve-publike-1/>)

¹⁰ Neni 26.1 dhe Neni 29.1.3. Ligji Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës. Tetor 2022.

¹¹ "Betimi për Drejtësi 418: Qeverisja Kurti në konflikt interesi". Betimi për Drejtësi. 6 shtator 2025. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/betimi-per-drejtesi-418-qeverisja-kurti-ne-konflikt-interesi/>)

koncepti i Qeverisë në detyrë i referohet qeverisë si institucion dhe jo anëtarit të qeverisë si individ, i cili gjendet në papajtueshmëri nëse ushtron njëkohësisht edhe postin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në këtë situatë, bazuar në dispozitat ligjore dhe kushtetuese, nuk kërkohet që mos të funksionojë Qeveria në detyrë apo në dorëheqje, por se kërkohet që në përbërjen e kësaj Qeverie mos të ketë persona që aktualisht mbajnë pozitën e deputetit. Kështu, Qeveria duhet të lirohet nga anëtarët e saj të cilët janë zgjedhur deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në pozitat e tyre mund të vazhdojnë zëvendësit e ministrave, të cilët nuk mbajnë pozitën e deputetit në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Sipas Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë, këtë veprim anëtarët e Qeverisë është dashur ta marrin para certifikimit të tyre si deputetë.¹²

Përtej normave specifike, ushtrimi i njëkohësishëm i mandatit të deputetit dhe anëtarit të qeverisë është në kundërshtim me dizajnimin kushtetues institucional. Sipas Kushtetutës, është Kuvendi ai që mbikëqyrë punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës¹³. Në këtë situatë, nëse i njëjti person ushtron si pozitën e deputetit ashtu edhe pozitën e anëtarit të Qeverisë, atëherë i bie se i njëjti person është njëkohësisht pjesë si e institucionit mbikëqyrës, Kuvendit, ashtu edhe e institucionit të mbikëqyrur, Qeverisë.

Përpos papajtueshmërisë, neni 26 i Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë ka adresuar edhe çështjen e konfliktit të interesit. Sipas paragrafit të këtij neni, “[p]ërveç kufizimeve të këtij neni, anëtarët e Qeverisë i nënshtrohen edhe kufizimeve të përcaktuara me legjislacionin përkatës për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik”. Qëllimi i këtij ligji është forcimi i integritetit të sektorit publik dhe garantimi i kryerjes së detyrave publike në mënyrë objektive, të paanshme dhe transparente në shërbim të interesit publik nëpërmjet identifikimit, parandalimit, menaxhimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesave të zyrtarëve. Ushtrimi i funksionit në përputhje me ligjin, ruajtja e autoritetit të zyrtarit dhe institucionit, veprimi në mbrojtje të interesit publik, shmangia e konfliktit të interesit etj. janë disa nga parimet e veprimit dhe mosveprimit të zyrtarit sipas këtij Ligji¹⁴. Në raste të caktuara, konflikti i interesit paraqet edhe vepër penale.¹⁵

Për këtë arsye, është tërësisht e qartë se kemi të bëjmë me kundërkushtetutshmëri dhe kundërligjshmëri të hapur nëse një person mbanë njëkohësisht si pozitën e deputetit ashtu edhe pozitën e anëtarit të qeverisë.

4. Vendimi i Gjykatës Supreme

Papajtueshmëria e mbajtjes së të dy pozitave, asaj të deputetit dhe të anëtarit të qeverisë, ishte objekti i shqyrtimit edhe nga Gjykata Supreme në një rast specifik. Fillimisht, dy biznese ushtruan padi në Gjykatën Supreme, duke kërkuar që të shpallet i paligjshëm dhe të shfuqizohet

¹² Neni 26.1. Ligji Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës. Tetor 2022

¹³ Neni 65 (9). Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Qershor, 2008

¹⁴ Neni 1 dhe Neni 5. Ligji Nr. 06/L -011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Mars, 2018.

¹⁵ Neni 417. Kodi NR. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës. Nëntor, 2018.

një udhëzim administrativ. Bëhet fjalë për Udhëzimin Administrativ nr.01/2025 për Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike Fiskale, Sistemeve Fiskale dhe Softuerëve Elektronikë Fiskal. Ky udhëzim administrativ ishte nxjerrë nga Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) dhe ishte publikuar në Gazetën Zyrtare më 16 prill 2025.

Kjo kërkesë padi u aprovua si e themeltë, ashtu që udhëzimi administrativ i MFPT u shpall i paligjshëm dhe u shfuqizua¹⁶. Mirëpo, arsyeja kryesore për këtë kundërligjshmëri ishte fakti se Ministri i MFPT, Hekuran Murati, në kohën e nxjerrjes së këtij Udhëzimi Administrativ ishte duke ushtruar edhe pozitën e deputetit të Kuvendit. Pra, Gjykata Supreme konstatoi se udhëzimi administrativ në fjalë ishte nxjerrë nga dikush që nuk kishte qenë vetëm Ministër i Qeverisë në detyrë, por njëkohësisht edhe deputet që merrte pjesë në procesin e konstituimit të Kuvendit.

Në këtë vendim të Gjykatës Supreme u konstatua se *“Për gjykatën ishte i pakontestueshëm fakti se nga certifikimi zyrtar i rezultateve të zgjedhjeve, më datë 27.03.2025, ministri i MFPT Hekuran Murati figuron si deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Sipas nenit 71 të Kushtetutës, ushtrimi i funksioneve të deputetit dhe të ministrit në të njëjtën kohë është i ndaluar. Për pasojë, nxjerrja e Udhëzimit Administrativ nga një person që ushtron njëkohësisht detyrën e deputetit dhe të ministrit është e kundërligjshme dhe shkel dispozitat kushtetuese.... Ministri i Financave ka qenë në pozitë të papajtueshme funksionale në kohën e nënshkrimit, duke qenë i certifikuar si deputet në shkellje të neneve 70.2 dhe 71 të Kushtetutës, të cilat ndalojnë ushtrimin paralel të funksioneve ekzekutive dhe legjislative, si dhe parimin e ndarjes dhe kontrollit të pushteteve të përcaktuar në Kushtetutë. Gjykata nuk ka arsyetuar pretendimet e tjera, duke konsideruar se mungesa e autorizimit ligjor në rastin konkret si dhe konflikti i interesit për nënshkrimin e një akti nënligjor normativ, për arsyet e lartë theksuara ishin të mjaftueshme për aprovimin e kërkesëpadisë së paditësve, shpalljen e paligjshmërisë dhe shfuqizimin e aktit të kontestuar...”*¹⁷

Kështu, përtej këtij rasti, Gjykata Supreme konfirmoi se anëtarët e Qeverisë në detyrë, ligjërisht nuk janë anëtarë të kësaj Qeverie, nëse të njëjtit ushtrojnë në të njëjtën kohë edhe pozitën e deputetit.

Megjithatë, konfirmimin e kësaj situate përmes vendimit të Gjykatës Supreme, Qeveria Kurti II nuk reflektoi. Përkundrazi, pas konfirmimit të kundërkushtetutshmërisë dhe kundërligjshmërisë në mbajtjen e të dy pozitave, i menjëhershëm ishte reagimi i Qeverisë në detyrë, që vendimin e Supremes e quajti *“të pabazuar në ligj”* dhe *“arbitrar”*¹⁸. Përveç Qeverisë, edhe ministri në detyrë, Hekuran Murati, përmes një postimi në rrjetin social Facebook, aktgjykimin e Supremes e kishte cilësuar *“absurd”* dhe duke i kritikuar me emër

¹⁶ Aktgjykimi i Gjykatës Supreme së Republikës së Kosovës (P.A.nr.09/2025), marrë më 15 qershor 2025. (Shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/SUP__09-2025_SQ.pdf).

¹⁷ Po aty. Faqe 9.

¹⁸ *“Qeveria e quan arbitrar vendimin e Supremes: I pabazuar në ligj dhe përbën interpretim të njëanshëm”*. Betimi për Drejtësi. 15 korrik 2025. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/qeveria-e-quan-arbitrar-vendimin-e-supremes-i-pabazuar-ne-ligj-dhe-perben-interpretim-te-njeanshem/>).

gjyqtarët e Supremes¹⁹. Kurse, Gjykata Supreme, me 16 korrik 2025, ka bërë një kundër reagim të deklaratave të Qeverisë, të cilat i ka quajtur “*ndërhyrje të papranueshme në pavarësinë e gjyqësorit*”.²⁰

Këto deklaratatë të Qeverisë pos se paraqesin ndërhyrje në punën e sistemit gjyqësor²¹, të njëjtat minojnë edhe rrugën e Kosovës drejt anëtarësimit në Këshillin e Evropës. Raporti i juristëve eminentë në lidhje me përputhshmërinë e sistemit ligjor kosovar me standardet e Këshillit të Evropës thekson se politikanë në pozita përgjegjëse ndonjëherë kritikojnë vendimet gjyqësore në raste të ndjeshme me gjuhë të papërshtatshme dhe në një mënyrë që mund të minojë pavarësinë gjyqësore²². Ky raport rekomandon që autoritetet në Kosovë të respektojnë plotësisht pavarësinë e gjyqësorit, duke përfshirë përmbajtjen nga kritika të tepruara që minojnë besimin në gjyqësor.²³

Edhe pas këtij vendimi të Gjykatës Supreme, anëtarët e Qeverisë në detyrë të cilat janë duke ushtruar edhe pozitën e deputetit nuk kanë dhënë dorëheqje, por kanë vazhduar të mbajnë njëkohësisht të dy (2) pozitat. Kjo duke vepruar në kundërshtim të hapur me Kushtetutën dhe Ligjin dhe duke mos zbatuar aktgjykimin e Gjykatës Supreme. Në këtë situatë, Kosova është duke u qeverisur nga një Qeveri në detyrë, përbërja e së cilës është kundërkushtetuese dhe kundërligjore, fakt ky i konfirmuar edhe nga Gjykata Supreme.

Sipas interpretimit të Gjykatës Supreme, rezulton se të gjitha vendimet e Qeverisë apo të anëtarëve të saj të cilët mbajnë në të njëjtën kohë pozitën e deputetit janë të kundërligjshme. Kjo pasi, në kontekst të aktgjykimit të Gjykatës Supreme, mbajtja faktike e pozitës së anëtarit të qeverisë nuk e ligjëson mbajtjen e pozitës.

5. Pasojat e mos zbatimi të vendimit të Gjykatës Supreme

Nga të gjitha ato që u elaboruan më sipër, kjo situatë ka bërë që Kosova të qeveriset nga një Qeveri kundërkushtetuese dhe kundërligjore, e cila refuzon të zbatojë një vendim gjyqësor.

¹⁹ "Hekuran Murati sulmon Gjykatën Supreme që ia rrëzoi udhëzimin për arkat fiskale, përmend gjyqtarët me emër". Gazeta Express. 15 korrik 2025. (Shih linkun: <https://www.gazetaexpress.com/hekuran-murati-sulmon-gjykatën-supreme-që-ia-rrëzoi-udhëzimin-per-arkat-fiskale-permend-gjyqtaret-me-emër/>).

²⁰ "Gjykata Supreme i reagon Qeverisë: Ndërhyrja në vendime gjyqësore është e papranueshme". Radio Evropa e Lirë. 16 korrik 2025. (Shih linkun: <https://www.evropaelire.org/a/gjykata-supreme-i-reagon-qeverise/33475582.html>).

²¹ Jakaj, N. dhe Zekaj, E. "Ndërhyrjet në sistemin e drejtësisë përmes deklaratave publike". Instituti i Kosovës për Drejtësi. Dhjetor 2023. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2023/12/Nderhyrjet-ne-sistemin-e-drejtësisë-permes-deklaratave-publike-1-1.pdf>).

²² "Application for membership set out in the letter of 12 May 2022 addressed to the Secretary General of the Council of Europe, in line with Statutory Resolution (51) 30 (Report by the eminent laëyers appointed by the Bureau on 25 May 2023)". Faqe 15, paragrafi 89. Këshilli i Evropës. 27 nëntor 2023. (Shih linkun: <https://rm.coe.int/application-for-membership-set-out-in-the-letter-of-12-may-2022-addres/1680ad7750>).

²³ Po aty.

Sipas Komisionit të Venecias, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore në mënyrë të shpejtë dhe efektive është njëri prej indikatorëve crucial të sundimit të ligjit²⁴. Në rastin tonë, Qeveria Kurti II refuzoi ta përmbushë vendimin e Gjykatës Supreme, duke kritikuar publikisht si Gjyqësorin ashtu edhe gjyqtarët e Gjykatës Supreme. Qeveria u kujdes që të përmbushë vetëm kriterin formal të implementimit të vendimit të Gjykatës Supreme, ashtu që impelementimi u kufizua vetëm në udhëzimin administrativ specifik, por se praktika e kundërligjshme e cila u konstatua nga Gjykata Supreme u vazhdua. Kur një mënyrë e tillë e veprimit vie nga Qeveria e Republikës së Kosovës, e njëjta jep një sinjal tejet të rëndë për sundimin e ligjit në Kosovë.

Gjykata Supreme konfirmoi se një anëtarë i Qeverisë, nuk është anëtarë i Qeverisë nëse në të njëjtën kohë është certifikuar si deputetë. Mbajtja e të dy (2) pozitave njëkohësisht përkundër këtij vendimi të Gjykatës Supreme nënkupton uzurpim të zyrave të qeverisë.

Kjo situatë i ka sjellë Kosovës pasoja negative në shumë drejtime. Sipas një letre të publikuar në media, pas vendimit të Supremes, Zyra e BE-së në Kosovë i ka shkruar Kurtit, se *“Në përputhje me këtë aktgjykim dhe në interes të qëndrueshmërisë institucionale dhe respektimit të sundimit të ligjit, vizitorët e nivelit të lartë nga Shtetet Anëtare të BE-së dhe institucionet e BE-së do të përmbahen, përkohësisht, nga mbajtja e takimeve me Kryeministrin në detyrë dhe ministrat brenda ndërtesës së Qeverisë së Kosovës, derisa të jetë në funksion një Qeveri me mandat të plotë”*. Kjo masë, thuhet se *“thekson përkushtimin e BE-së ndaj sundimit të ligjit, llogaridhënies demokratike dhe integritetit institucional”*.²⁵

Siç theksoi Gjykata Supreme, vendimet e nxjerra nga anëtarët e Qeverisë në detyrë, të cilët mbajnë njëkohësisht edhe pozitën e deputetit në Kuvendin e Republikës së Kosovës konsiderohet të paligjshme. Përkundër kësaj, Qeveria dhe anëtarët e Qeverisë kanë vazhduar të marrin vendime edhe pas aktgjykimit të Gjykatës Supreme²⁶. Kjo situatë bënë që rendi juridik të mbushet me vendime të kundërligjshme, duke u cenuar kushtetutshmëria dhe ligjshmëria e funksionimit të rendit juridik kosovar.

Secili prej vendimeve të nxjerra në këtë mënyrë mund të kontestohet në Gjykatë dhe bazuar në vendimin e Gjykatës Supreme, të njëjtat shfuqizohen pa u lëshuar fare në përmbajtjen e vendimit të caktuar. Mirëpo, mundësia e atakimit të këtyre vendimeve në Gjykatë nuk pakëson dëmin që krijon qeverisja e kundërligjshme nga Qeveria në detyrë, për shkak se është e pamundur që secili prej vendimeve të atakohet në Gjykatë. Kjo për faktin se në disa raste nuk ka palë direkte të afektuara, e në disa raste kosto e zhvillimit të procedurës gjyqësore mund të jetë e papërballueshme.

Për të gjitha këto arsye, dëmet që ka krijuar qeverisja kundërkushtetuese, e përbërë nga anëtarë të cilët në të njëjtën kohë mbajnë edhe pozitën e deputetit janë shumëdimensionale. Kjo mënyrë

²⁴ "THE RULE OF LAË CHECKLIST". Faqe 46. Komisioni i Venecias. Venecia, 11-12 mars 2016. (Shih linkun: https://www.venice.coe.int/images/SITE%20IMAGES/Publications/Rule_of_Laë_Check_List.pdf).

²⁵ "BE pezullon takimet me Qeverinë në detyrë të Kosovës pas vendimit të Gjykatës Supreme". Telegrafi. Shtator 2025. (Shih linkun: <https://telegrafi.com/pezullon-takimet-qeverine-ne-detyre-te-kosoves-pas-vendimit-te-gjykates-supreme/>).

²⁶ "Betimi për Drejtësi 418: Qeverisja Kurti në konflikt interesi". Betimi për Drejtësi. 6 shtator 2025. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/betimi-per-drejtesi-418-qeverisja-kurti-ne-konflikt-interesi/>).

e veprimit ka cenuar imazhin e Kosovës tek partnerët ndërkombëtarë si dhe ka cenuar në thelb sundimin e ligjit në Kosovë, duke e mbushur rendin juridik me vendime të kundërligjshme.

Kjo mënyrë e veprimit paraqet një shembull tejet negativ në demokracinë e re Kosovare. Qytetarët e Kosovës dhe partnerët ndërkombëtarë arsyeshëm kanë pritje se institucionet kosovare do të zbatojnë vendimet gjyqësore, gjë të cilën nuk e bëri në rastin konkret Qeveria Kurti II.

Krejt në fund, duhet theksuar se kjo mënyrë e veprimit nga ana e anëtarëve të Qeverisë Kurti II rrezikon të kthejë mbrapa edhe procesin e përzgjedhjes së Kryetarit të ri të Kuvendit. Me 26 gusht Kuvendi i Republikës së Kosovës me 73 vota për, ka zgjedhur Kryetarin e ri të Kuvendit. Në këtë numër të votave pro zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit bëjnë pjesë edhe votat e 17 deputetëve, të cilët në momentin e votimit mbanin edhe postin e anëtarit të qeverisë. Nëse hiqen votat e tyre, atëherë i bie se as procesi i zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit nuk ishte valid, për shkak të mungesës së votave. Kjo çështje mund të trajtohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila mund të vendosë për validitetin e procesit të, ndër të tjera, përzgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit.

6. Përgjegjësia penale

Sipas Kodit NR. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, mos ekzekutimi i vendimeve gjyqësore paraqet vepër penale. Sipas këtij kodi, *“Personi zyrtar apo personi përgjegjës i cili refuzon të ekzekutoj urdhrin, vendimin apo aktgjykimin e plotfuqishëm të ndonjë gjykate të Republikës së Kosovës apo i cili nuk e ekzekuton vendimin brenda afatit ligjor apo afatit të caktuar me vendim, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet”*. Sipas këtij Kodi, nëse kjo vepër penale shkakton shkelje të rëndë të drejtave njerëzore apo dëm substancial material, kryesi dënohet me burgim nga gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vite.²⁷

Në këtë situatë, mënyra e veprimit të Qeverisë në detyrë, duke vazhduar mbajtjen e pozitave të anëtarit të qeverisë në detyrë edhe pas vendimit të Gjykatës Supreme paraqet vepër penale sipas Kodit Penal.

Në lidhje me ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Supreme, qëndrimi publik i Qeverisë në detyrë ishte se ai është zbatuar. Sipas tyre, vendimi i Gjykatës Supreme kishte të bënte vetëm me një udhëzim administrativ dhe i njëjti nuk e ka fuqinë e precedentit²⁸. Në këtë situatë, Qeveria tenton ta shmangë përgjegjësinë e saj penale për mos zbatim të vendimit të Gjykatës Supreme, përmes zbatimit të tij në raport me udhëzimin administrativ specifik.

Ky argument nuk mund të cilësohet valid. Kjo pasi përkundër faktit se vendimi i Gjykatës Supreme kishte të bënte me një vendim specifik, interpretimi i dhënë nga Gjykata Supreme është pjesë e vendimit të saj. Në këtë vendim, Gjykata Supreme specifikisht ka theksuar se

²⁷ Neni 394. Kodi NR. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës. Nëntor, 2018.

²⁸ "Betimi për Drejtësi 418: Qeverisja Kurti në konflikt interesi". Betimi për Drejtësi. 6 shtator 2025. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/betimi-per-drejtesi-418-qeverisja-kurti-ne-konflikt-interesi/>).

anëtari i Qeverisë i cili njëkohësisht mbanë edhe pozitën e deputetit nuk mund të konsiderohet edhe anëtarë i Qeverisë. Kjo është edhe arsyeja pse është shpallur i paligjshëm dhe është shfuqizuar vendimi specifik që ishte objekti i trajtimit në këtë vendim.

Kufizimi në implementimin vetëm formal të aktgjyqimit të Gjykatës Supreme nuk mund të konsiderohet implementim i këtij vendimi. Kjo për faktin se edhe nëse shmanget përgjegjësia për vepër penale të mos ekzekutimit të vendimit gjyqësor, mund të vie në shprehje përgjegjësia penale për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar. Sipas Kodit Penal, “**Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t’i shkaktojë dëm personit tjetër ose që t’i shkel të drejtat e personit tjetër; dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet**”²⁹. Vendimet e nxjerra nga Qeveria krijojnë pasoja për subjekte të ndryshme. Vendimi i Gjykatës Supreme theksoi se vendimet e nxjerra nga anëtarët e qeverisë të cilët mbajnë njëkohësisht pozitën e deputetit janë të kundërligjshme. Në këtë situatë, kundërligjshmëria u qartësua nga Gjykata Supreme dhe vazhdimi i mbajtjes së pozitës së anëtarit të qeverisë nga personat që njëkohësisht janë edhe deputet, paraqet kundërligjshmëri të hapur, e cila kundërligjshmëri në raste të caktuara mund të tërheqë pas vetës përgjegjësi për veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar.

Në këtë situatë, përderisa Qeveria në detyrë nuk ka vullnet për të implementuar aktgjykimin e Gjykatës Supreme, është shumë e rëndësishme që të veprojë Prokurori i Shtetit, në mënyrë që të qartësojë përgjegjësinë penale në këtë situatë. Aktualisht, kjo çështje është duke u trajtuar nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK). Për mbajtjen e pozitave në kundërshtim me ligjin, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) më 8 maj 2025, kishte dorëzuar 17 kallëzime penale ndaj kryeministrit në detyrë, Albin Kurti dhe ministrave në detyrë që u bënë deputetë. Deri më tani, PSRK nuk ka njoftuar mbi rezultatin e trajtimit të këtyre kallëzime penale³⁰.

²⁹ Neni 414.1. Kodi NR. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës. Nëntor, 2018.

³⁰ "Betimi për Drejtësi 418: Qeverisja Kurti në konflikt interesi". Betimi për Drejtësi. 6 shtator 2025. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/betimi-per-drejtesi-418-qeverisja-kurti-ne-konflikt-interesi/>).

Pjesa II

Qeverisja me ushtrues detyre

7. Qeverisja me ushtrues detyre

Duke analizuar caktimin e ushtruesve të detyrës, në kontekst të kryetarëve të gjykatave, Komisioni i Venecias theksoi se caktimi i ushtruesve të detyrës duhet të jetë vetëm përjashtim dhe jo rregull. Sipas këtij Komisioni, kjo duhet të ndodhë vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe të paparashikueshme³¹. Sipas Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), caktimi i ushtruesve të detyrës është i nevojshëm për të siguruar funksionimin e pandërprerë të organeve publike dhe për të ofruar kohë që proceset e rekrutimit të finalizohen.³²

Kështu, standardet ndërkombëtare theksojnë se caktimi i ushtruesve të detyrës nuk duhet të trajtohet si rregull, por vetëm si përjashtim. Kjo në atë mënyrë që në rrethana të caktuara përjashtimore, të cilat nuk mund të parashikohen, të caktohen ushtruesit e detyrës, në mënyrë që organet publike të funksionojnë deri në zgjedhjen meritore të titullarit të ri.

E kundërta ka ndodhur në Qeverinë Kurti II. Gjatë kësaj Qeverisje, një numër jashtëzakonisht i madh i pozitive janë mbajtur për vite të tëra me ushtrues detyre, ashtu që nuk janë emëruar titullarët e ri përmes proceseve të rregullta dhe meritore të rekrutimit.

Sipas Raportit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2024 *“Aktivitetet e integritetit evropian u ndikuan negativisht edhe nga kapaciteti i dobët administrativ dhe fakti që një numër i konsiderueshëm i pozitive kyçe në administratën publike mbahen nga zyrtarë që po shërbejnë si ushtrues detyre”*³³. Po ashtu, edhe raporti i këtij Komisioni për vitin 2023 e theksonte këtë problematikë, ku nënvizonte se *“Përdorimi i gjerë i pozitive me ushtrues detyre në shërbimin*

³¹ "MONTENEGRO URGENT FOLLOË-UP OPINION ON THE REVISED DRAFT AMENDMENTS TO THE LAË ON THE JUDICIAL COUNCIL AND JUDGES". Komisioni i Venecias. Faqe 25. Strasbourg, 24 qershor 2024. (Shih linkun: [https://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2024\)012-e](https://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2024)012-e)).

³² "ANALYSIS OF THE PROFESSIONALISATION OF THE SENIOR CIVIL SERVICE AND THE ËAY FORËARD FOR THE ËËSTERN BALKANS SIGMA Paper No. 55". Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik. Faqe 62. 19 korrik 2018. (Shih linkun: [https://one.oecd.org/document/GOV/SIGMA\(2018\)1/en/pdf#:~:text=The%20institution%20of%20acting%20senior,Balkan%20legislations%20except%20the%20FBiH](https://one.oecd.org/document/GOV/SIGMA(2018)1/en/pdf#:~:text=The%20institution%20of%20acting%20senior,Balkan%20legislations%20except%20the%20FBiH)).

³³ "Kosovo 2024 Report". Komisioni Evropian. Faqe 22. Bruksel, 30 tetor 2024. (Shih linkun: https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en?filename=Kosovo+Report+2024.pdf).

*civil, veçanërisht në nivelet e larta menaxheriale, si dhe procedurat joefikase të rekrutimit të jashtëm për menaxhmentin e lartë, kanë minuar cilësinë e menaxhimit në institucione”.*³⁴

Raporti i monitorimit të SIGMA gjeti se deri në shtator 2024, vetëm 15 pozita ishin të mbushura me të emëruar të rregullt, ndërsa pjesa tjetër e pozitave vazhdonin të mbaheshin nga menaxherë në cilësinë e ushtruesve të detyrës. Sipas këtij raporti, përqindja e zyrtarëve të lartë që shërbenin si ushtrues detyre ishte jashtëzakonisht e lartë, duke arritur në 85%. Vetëm 7 nga 16 sekretarët e përgjithshëm ishin emëruar përmes një procedure të hapur të rekrutimit të jashtëm.³⁵

Raporti vjetor i auditimit për vitin 2024, i publikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit, e evidentoi po ashtu si problematike mbajtjen e pozitave me ushtrues detyre. Sipas këtij raporti, ndër mangësitë e identifikuarra te pagat dhe mëditjet ishin mbulimi i pozitave me ushtrues detyre përtej afatit ligjor. Për këtë, raporti në fjalë nënvizoi se *“Te pagat dhe shtesat janë identifikuar dobësi në proceset e rekrutimit, emërimet dhe ushtrime në detyrë në kundërshtim me kërkesat ligjore, tejkalim të afateve ligjore për ushtruesit e detyrës...”*.³⁶

Për vite me radhë, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) nëpërmjet produkteve të ndryshme të publikuara ka ngritur shqetësim për mbajtjen e numrit të madh të pozitave me ushtrues detyre³⁷. Megjithatë, për dallim nga kërkesat ligjore dhe standardet ndërkombëtare, mbajtjen e pozitave me ushtrues detyre Qeveria Kurti II e ka cilësuar si rregull, në vend se ta cilësonte si përjashtim.

8. Korniza ligjore

Ligji NR. 08/L-197 për Zyrtarët Publik e ka trajtuar edhe çështjen e ushtruesve të detyrës. Sipas këtij Ligji, *“Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë”*.³⁸

Ligji në fjalë po ashtu e ka kufizuar periudhën kohore se sa një pozitë mund të mbahet me ushtrues detyre. Sipas këtij Ligji, *“Zyrtarja/i publik nuk mund të caktohet si ushtruese/i detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë”*. Ligji në fjalë specifikoi se pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se ky afat dhe se çdo vendim i marrë jashtë këtij afati është i paligjshëm.³⁹

³⁴ "Kosovo 2023 Report". Komisioni Evropian. Faqe 13. Bruksel, 8 nëntor 2023. (Shih linkun: [SËD_2023_692_Kosovo_report_0.pdf](#)).

³⁵ "Public administration in Kosovo* 2024". Faqe 58. SIGMA Monitoring Reports. 2025. (Shih linkun: https://www.oecd.org/content/dam/oecd/en/publications/reports/2025/01/public-administration-in-kosovo-2024_d9378da9/a53fce6b-en.pdf).

³⁶ "Raporti vjetor i auditimit 2024". Zyra Kombëtare e Auditimit. Faqe 61-62. Prishtinë, gusht 2025. (Shih linkun: https://zka-rks.org/cms/ReportFiles/2025_f55bfd12-deb7-4182-a525-d74fdb2a25fe.pdf).

³⁷ "Tempus 166: Paligjshmëria e qeverisjes me ushtrues detyre". Betimi për Drejtësi. 14 korrik 2025. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/tempus-166-paligjshmeria-e-qeverisjes-me-ushtrues-detyre/>); "Betimi për Drejtësi 389: “Qeverisja e mirë” përmes pozitave me ushtrues detyre”. Betimi për Drejtësi. 4 janar 2025. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/betimi-per-drejtesi-389-qeverisja-e-mire-permes-pozitave-me-ushtrues-detyre/>).

³⁸ Neni 35.1. Ligji NR. 08/L-197 për Zyrtarët Publik. Dhjetor, 2022.

³⁹ Neni 35, paragrafët 3-5. Po aty.

Sa i përket afatshmërisë kohore, në qershor të vitit 2025 ka hyrë në fuqi Ligji NR. 08/L-294 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit NR. 08/L-197 për Zyrtarët Publik. Ky ligj e ka zgjatur afatin ligjor se sa mund të mbahet një pozitë me ushtrues detyre. Sipas këtij Ligji, *“Zyrtari publik nuk mund të caktohet si ushtrues detyre më gjatë se dymbëdhjetë(12) muaj përveç rasteve kur procedura e rekrutimit është shpallur por për arsye objektive pozita nuk është plotësuar”* derisa *“Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se një periudhë prej dy (2) viteve”*.⁴⁰

Kështu, në vend se Qeveria Kurti II të angazhohej për plotësimin e vendeve të lira përmes proceseve meritore rekrutuese, ajo sponsorizoi një ligj përmes të cilit u zgjat afati për mbajtjen e pozitave me ushtrues detyre. Kjo qasje është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe integritetin e administratës.

9. Vendimi i Gjykatës Supreme

Megjithëse ishte miratuar një Ligj që kufizonte afatin kohor brenda të cilës pozitën mund të mbaheshin me ushtrues detyre, praktika ishte ndryshe. Në shumë institucione, zyrtarët publik nuk u emëruan përmes një procesi meritore rekrutues as pas kalimit të afatit prej 12 muajve. Në këto raste, praktika ishte që në rast të mos rekrutimit të një pozite të caktuar, ndryshohej emri i ushtruesit të detyrës, përkundër se ishte tejkaluar afati i përcaktuar me ligj.

Miratimi i një rregullore nga Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC) dhe kontestimi i saj aktivizoi Gjykatën Supreme që të vlerësoi ligjshmërinë e kësaj Rregullore. Kjo Rregullore ishte nxjerrë nga ushtruesi i detyrës së Drejtorit të AAC, pozitë kjo e cila po mbahej me ushtrues detyre për një periudhë kohore më tepër se 12 muaj.

Duke interpretuar ligjshmërinë e nxjerrjes së kësaj rregullore, në kontekst të nenit 35 të Ligjit NR. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Gjykata Supreme theksoi se nga kjo dispozitë rrjedh qartë se çdo akt juridik i nxjerrë nga një udhëheqës në cilësinë e ushtruesit të detyrës pas skadimit të afatit prej një viti është i pavlefshëm në thelb, për shkak të mungesës së kompetencës ligjore për të ushtruar funksionet që burojnë nga ajo pozitë. Në rastin konkret, Gjykata Supreme theksoi se është fakt i dokumentuar dhe i pa kontestuar që pozita udhëheqëse e AAC-së është mbajtur në mënyrë të vazhdueshme nga ushtrues detyre për një periudhë më të gjatë se një vit, pa u bërë emërim i rregullt, dhe për më tepër, rregullorja e kontestuar është nxjerrë pikërisht gjatë kësaj periudhe të tejkaluar. Për këtë, Gjykata Supreme theksoi se ligji i referohet pozitës si funksion institucional dhe jo individit si person: *“Pra, ndërrimi i personit nuk e ndërpret dhe nuk e rifillon afatin gjashtë mujor, përkatësisht njëvjeçar të ushtrimit të përkohshëm të pozitës. Kjo qasje është në përputhje me frymën e ligjit që kërkon stabilitet, profesionalizëm dhe përgjegjësi institucionale në udhëheqjen publike”*.⁴¹

⁴⁰ Neni 9, paragrafët 2 dhe 3. Ligji NR. 08/L-294 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit NR. 08/L-197 për Zyrtarët Publik.

⁴¹ Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (P.A.nr.07/2025), marrë më 10 qershor 2025. Faqe 10. (Shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/SUP_07_2025_SQ.pdf).

Për këto arsye, Gjykata Supreme vlerësoi se Rregullorja në fjalë është e paligjshme: *“pretendimet e palës paditëse për tejkalim afati janë të bazuara në dispozitat eksplicite ligjore dhe kanë për qëllim mbrojtjen e legjitimitetit të aktit dhe sigurinë juridike në funksionimin e institucioneve. Respektimi i kufizimeve kohore është thelbësor për funksionimin ligjor dhe transparent të institucioneve publike. Çdo shkelje e këtyre normave sjell pasoja negative në zbatimin e drejtë të ligjit dhe mund të krijojë precedentë të dëmshëm. Kështu, pretendimet e palës paditëse gjejnë mbështetje në parimet e ligjshmërisë dhe rendit kushtetues, të cilat i mbështet dhe i konstaton edhe gjykata”*.⁴²

Ky aktgjykim i Gjykatës Supreme vendosi se mbajtja e pozitive me ushtrues detyre nuk mund të bëhet përtej afatit të përcaktuar me ligj, edhe nëse ndryshohet emri i ushtruesit të detyrës. Në rast se kjo ndodhë, sipas Gjykatës Supreme, të gjitha aktet e nxjerra nga ushtruesi përkatës i detyrës konsiderohen të paligjshme. Kështu, ky aktgjykim tregon se në të gjitha rastet kur pozitat janë të mbuluara me ushtrues detyre, nëse ka kaluar afati i përcaktuar me ligj, ato pozita janë duke u mbajtur në mënyrë të kundërligjshme dhe çdo vendim i nxjerr nga këta zyrtarë është i kundërligjshëm.

10. Pasojat e qeverisjes me ushtrues detyre

Siç u tha, standardet ndërkombëtare theksojnë rëndësinë që mbajtja e pozitive me ushtrues detyre duhet të trajtohet vetëm si përjashtim dhe jo si rregull. Në secilin rast, standardet e qeverisjes së mirë në administratën publike kërkojnë rekrutim të bazuar në meritë dhe jo mbajtje të pozitive me ushtrues detyre.

Në mënyrë që mos të vije deri tek nevoja për caktimin e ushtruesve të detyrës, institucionet duhet të zhvillojnë me kohë proceset rekrutuese. Plotësimi i duhur dhe i rregullt i pozitive garanton gjithashtu që numri i nëpunësve të lartë civilë që shërbejnë si ushtrues detyre të mbahet në minimum, mandati i tyre të jetë rreptësisht i kufizuar, ata të emërohen nga radhët e nëpunësve civilë ekzistues, dhe mundësia e caktimit të ushtruesve të detyrës të mos e anashkalojë në asnjë mënyrë rekrutimin dhe përzgjedhjen mbi bazë merite, por përkundrazi, të shërbejë vetëm si një zgjidhje e përkohshme për problemin e vakantit deri në kohën kur të mund të bëhet një emërim mbi bazë merite⁴³. Megjithatë, siç u theksua, Qeveria Kurti II është karakterizuar si qeveri me ushtrues detyre. Kjo për faktin se të dhënat flasin qartësisht se kjo Qeveri mbajtjen e pozitive me ushtrues detyre e ka cilësuar si parim dhe jo si përjashtim.

Mbajtja e pozitive me ushtrues detyre ka pasoja shumëdimensionale. Në kuptim të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe aktgjykimit të Gjykatës Supreme në rastin e AAC, mbajtja e pozitive me ushtrues detyre përtej afatit të lejuar me ligj nënkupton ushtrim të kundërligjshëm të një pozite të caktuar. Kjo mënyrë e veprimit krijoi paralizim institucional, për shkak se nuk mundësohet operimi i rregullt i institucionit. Kjo për faktin se çdo vendim i nxjerrë nga një

⁴² Po aty.

⁴³ "ANALYSIS OF THE PROFESSIONALISATION OF THE SENIOR CIVIL SERVICE AND THE WAY FORWARD FOR THE EASTERN BALKANS SIGMA Paper No. 55". Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik. Faqe 28. 19 korrik 2018. (Shih linkun: [https://one.oecd.org/document/GOV/SIGMA\(2018\)1/en/pdf](https://one.oecd.org/document/GOV/SIGMA(2018)1/en/pdf)).

ushtrues detyre, jashtë afatit ligjor sa lejohet mbajtja e një pozite me ushtrues detyre, është vendim i kundërligjshëm.

Mbajtja e pozitave me ushtrues detyre cenon administrimin adekuat të një institucioni të caktuar. Ushtruesit e detyrës mbajnë pozitën e tyre për një periudhë transitore. Të njëjtit nuk kanë ndonjë vizion apo plan të caktuar mbi avancimin e institucionit përmes pozitës që mbajnë. Për këtë arsye, mbajtja e pozitave me ushtrues detyre është burim i pengimit të avancimit të institucioneve të administratës publike.

Krahas këtyre aspekteve, për arsye të ndryshme, mbajtja e pozitave me ushtrues detyre konsiderohet edhe si një burim i korrupsionit. Mbajtja e pozitave me ushtrues detyre mund të përdoret si një mjet për të shmangur proceset meritore rekrutuese. Procesi i rregullt rekrutues është përgjithësisht më rigoroz dhe shmangia e tij mund të përdoret për emërimin e të afërmeve në pozita të caktuara si ushtrues detyre. Mungesa e formalitetit për caktimin e ushtruesve të detyrës mundëson edhe caktimin e personave të pakualifikuara në këtë pozitë. Për këtë arsye, vet mënyra e caktimit të ushtruesve të detyrës paraqet një potencial të theksuar korruptiv.⁴⁴

Një raport i Këshillit Kombëtar Kundër Korrupsionit, i publikuar në vitin 2025, duke analizuar çështjen në kontekst të kapjes së shtetit dhe abuzimit me emërimet e përkohshme në Afrikën e Jugut, gjeti se emërimi i menaxherëve të lartë si ushtrues detyre ishte përdorur qëllimisht për të mbrojtur zyrtarët e korruptuar dhe për të larguar ata që përpiqeshin të mbanin përgjegjësi personat e përfshirë në korrupsion. Raporti theksoi se një taktikë e përdorur gjerësisht ishte vendosja e personave në pozita të përkohshme, me qëllim që ata të mund të hiqeshin lehtësisht nëse nuk zbatonin urdhrat e eprorëve politikë, duke krijuar kështu terren për varësi politike, mungesë profesionalizmi dhe kulturë institucionale toksike.⁴⁵

Në këtë mënyrë, çështja e mbajtjes së pozitave me ushtrues detyre nuk është vetëm çështje e administrimit të administratës publike. Trajtimi si rregull i mundësisë përjashtuese të caktimit të ushtruesve të detyrës paraqet një burim serioz të korrupsionit. Kjo për shkak të mungesës së procedurave për caktimin e ushtruesve të detyrës dhe mungesës së mbrojtjes ligjore të ushtruesve të detyrës nga shkarkimi.

Për të gjitha këto arsye, qeverisja me ushtrues detyre është e kundërta e qeverisjes së mirë. Andaj, kjo qasje qeveritare e ndjekur nga Qeveria duhet të shmanget, duke ndjekur me përpikëri proceset meritore të rekrutimit të pozitave të caktuara dhe jo mbajtjen e tyre me ushtrues detyre.

⁴⁴ "Acting appointments open door to abuse". Sunday Times. 10 gusht 2014. (Shih linkun: <https://www.timeslive.co.za/sunday-times/business/2014-08-10-acting-appointments-open-door-to-abuse/#:~:text=As%20you%20suggest%2C%20they%20can.It%20defines>)

⁴⁵ "Final Report To the President, the Cabinet, and the Country". National Anti-Corruption Advisory Council. Faqe 57. Gusht 2025. (Shih linkun: <https://thepresidency.gov.za/sites/default/files/2025-09/National%20Anti-Corruption%20Advisory%20Council%20Final%20Report%202025.pdf#:~:text=they%20hold,and%20interfere,nce%20in%20their%20jobs>).

